



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 95, Datë 20.04.2018

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ÇAUSHI ENERGY” SH.P.K., PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME NR. 181, SERIA PV12K, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 122 DATË 29.08.2012.

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016; neni 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.04.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi modifikimin e licencës së shoqërisë “ÇAUSHI ENERGY” sh.p.k.,

Konstatoi se:

- Me shkresën nr. 01 Prot, datë 07.02.2018, protokolluar në ERE me nr. 312, datë 11.04.2018, shoqëria “ÇAUSHI ENERGY” sh.p.k., ka paraqitur kërkesë për (shitesë fuqie), modifikimin e licencës aktuale me nr. 181, Seria PV12K për “Prodhimin e Energjisë Elektrike” nga Hec “Qafëzezë”, me fuqi të instaluar 400 KW.
- Shoqëria “ÇAUSHI ENERGY” sh.p.k., është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Qafëzezë” me fuqi të instaluar 400 KW, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-S nr. 122, datë 29.08.2012.

Aplikimi i shoqërisë “ÇAUSHI ENERGY” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:

- Informacioni me shkrim ku janë spjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (neni 15, pika 4, gërma “a”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (neni 15, pika 4, gërma “b”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera (neni 15, pika 4, gërma “c”). Aplikuesi ka paraqitur: Kontratë Shtesë “Për disa ndryshime dhe shtesa në Kontratën e Koncesionit (nr.2452 Rep., nr.307 Kol., datë 24.07.2009) të formës “BOT”, për ndërtimin e Hec “Qafëzezë“, mbajtur në datën 21.02.2017, me nr 529 Rep., nr.201/1 Kol., midis MEI si Autoritet Kontraktues dhe shoqërisë “CAUSHI/K” sh.p.k. me cilësinë e Koncesionarit.
- Ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi : (neni 15, pika 4, gërma “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të ketë plotësuar pagesat e rregullimit në ERE (neni 15, pika 4, gërma “e”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “ÇAUSHI ENERGY” sh.p.k., dhënë me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 122 datë 29.08.2012, me nr. 181, Seria PV12K për “Prodhimin e Energjisë Elektrike” nga Hec “QAFËZEZË” me fuqi të instaluar 400 KW, e cila do të bëhet 1450 KW.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

